



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
KËSHILLI I BASENIT UJOR ISHËM ERZEN –TIRANË

Nr 3556/18 prot

Datë, 23/07/2018

VENDIM
Nr. 25 Datë. 12/07/2018

PËR

MIRATIMIN E LEJES PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR(PUS-SHPIM)
RR.PERLAT REXHEPI,TIRANË PËR SUBJEKTIN “ERA 2000” SHPK PËR
QËLLIME SANITARE.

Në mbështetje të ligjit Nr.111/2012 Datë 15.11.2013 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" neni.41 pika 1 gërma "e" neni.50 pika 2; Vendimin Nr. 416, datë 13.5.2015 "Për miratimin e kushteve të përgjithshme e të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatit të vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit e vendimmarrjes dhe formateve të autorizimit e lejes për përdorim të burimeve ujore", vendimit Nr.6 datë 16.02.2016 "Për miratimin e rregullores "Për funksionimin e Agjencisë së Basenit Ujor" neni 11 pika 3, dhe vendimit nr.5 datë 16.02.2016 Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Basenit Ujor" neni 7 pika 3, neni 16; Këshilli i Basenit Ujor Ishëm-Erzen,

V E N D O S I :

1. Miratimin e lejes për përdorimin e burimit ujor nëntokësor (pus-shpim) "ERA 2000"shpk me administrator z.Emin Shini me aktivitet kryesor në fushën e bareve restoranteve etj, me adresë; Rr.Perlat Rexhepi, Tiranë, me këto të dhëna:
 - Koordinatat : X 44 01 650 Y 45 76 860 Z 109 m
 - Kapaciteti i pusit 0.5 l/s
 - Thellësia e pusit 130 m
 - Volumi maksimal i ujit që kërkohet 0.5 l/s
 - Qëllimi i përdorimit : Ujë sanitar
 - Vendi i shkarkimit të ujërave të përdorur Rrjeti i kanalizimeve të zonës
2. Ngarkohet ABU Ishëm-Erzen për zbatimin dhe mbikqyrjen e këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi mbas zbardhjes dhe njoftimit të palës së interesuar

PËR KËSHILLIN E BASENIT UJOR ISHËM-ERZEN

SEKRETAR
Dorina ÇAPENI



KRYETAR
Suzana JAHOLLARI

